



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1102/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha edhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Mehmet Krasniqi kryetar i degës së subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Obiliq, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Prishtinë, për shkak të parregullsive në ndarjen e ulëseve për kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Obiliq, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Mehmet Krasniqi kryetar i degës së subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Obiliq.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 03.12.2013, ka pranuar një ankesë nga Mehmet Krasniqi kryetar i degës së subjektit politik LDK, në Obiliq në të cilën theksohet se kërkojmë nga KQZ që të rishikojë edhe njëherë rezultatet përfundimtare në komunën tonë për asamblenë pasi mendojmë se LDK-së i është bërë e padrejtë në përfaqësim duke e parë diferencën në vota ndërmjet LDK-së 2766 dhe LB-së 1800, pra kjo është diku rreth 8% e totalit të votave ndërsa përfaqësimi është 5-LDK-LB-4 si dhe Demokratska Iniciativa me 359 vota.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë nuk qëndrojnë ngase shpërndarja e vendeve nëpër kuvende komunale bëhet në bazë të nenit 8.1 të Ligjit për Zgjedhjet Lokale, me formulën të cilën e zbaton KQZ-ja për shpërndarjen e votave nëpër asamblenë, andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, PZAP-i, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.1102/2013 më datën 06.12.2013

**Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani**



Këshillë Juridike:

Ndaj ketij vendimi mund të paraqitni ankese në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.